


Shërbimi
i Securitë
p. 10.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2026

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim **projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.33, datë 31.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar**”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Antoneta Shumë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë ____/____/2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33, DATË 31.03.2021 “PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 33, datë 31.03.2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 6, paragrafi 1, pas fjalës “drejtorie” shtohet fjala “njësie”.

Neni 2

Në nenin 17 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi 1 formulohet si vijon:

“1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit dhe i jepet grada “Drejtues madhor”. Ai përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Gardës që mbajnë gradën “Drejtues i Parë/Drejtues i Lartë”.

2. Paragrafi 2, fjalia e parë ndryshon dhe formulohet si vijon:

“2. Drejtori i Përgjithshëm duhet të përmbushë këto kritere:”

3. Gërmat d) dhe dh) të paragrafit të dytë shfuqizohen.

4. Gërma e) ndryshohet si vijon:

“e) të mos jetë larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 viteve të fundit;”

Neni 3

Në nenin 19 bëhen ndryshime si vijon:

1. Ndryshohet titulli i nenit duke hequr togfjalëshin *“dhe drejtorët e drejtorive”*.

2. Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“3. Zëvendës drejtori emërohet nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Gardës. Ai zgjidhet nga punonjësit e Gardës që mbajnë gradën “Drejtues i parë”. Në momentin e emërimit zëvendës drejtori merr gradën “Drejtues i Lartë”. ”

3. Në paragrafin 4 pas fjalës “drejtorit” shtohet “të përgjithshëm”.

4. Paragrafi 5 dhe 6 shfuqizohen.

5. Pas paragrafit 4, shtohet paragrafi 4.1 me këtë përmbajtje

“4.1. Zëvendës drejtori i përgjithshëm rimerr gradën “Drejtues i Parë” kur transferohet në një funksion tjetër”.

Neni 4

Në nenin 21 bëhen shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“3. Bazuar në nevojat e identifikuar për rekrutimin e punonjësve me gradën “inspektor” deri “komisar”, shpallet konkurrimi për punonjës nga fushat e tjera të sigurisë, që plotësojnë kritreret e pikës 1 të këtij neni dhe të jenë deri në moshën 40 vjeç. Kalimi nga këto struktura në Gardën e Republikës realizohet duke ruajtur dhe njohur vjetërsinë e shërbimit.”

2. Pas paragrafit 5 shtohet paragrafi 6 me këtë përmbajtje:

“6. Procedurat, rregullat dhe mënyra e ekuivalentimit të gradave për punonjësit sipas pikës 3 me ato të Gardës së Republikës miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Neni 23 shfuqizohet.

Neni 6

Në neni 28, paragrafi 2 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

"2. Kohëzgjatja e transferimit zgjat për aq sa ekzitojnë shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni."

Neni 7

Neni 29 ndryshon si vijon:

1. Paragrafi 1, gërma b) ndryshon si vijon:

"b) merret njoftim nga organet ligjzbatuese se dyshohet që ka kryer veprime që çenojnë dinjitetin ose integritetin e institucionit;"

2. Pas gërmës b) të paragrafit 1, shtohet gërma c) me përmbajtjen si vijon:

"c) ka filluar hetimi për shkelje të rënda disiplinore nga struktura përgjegjëse në Gardën e Republikës."

3. paragrafi ndryshon me përmbajtjen si vijon:

"2. Pezullimi nga detyra për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni zgjat për aq kohë sa proceset të marrin formë të prerë."

Neni 8

Neni 30 ndryshohet si vijon:

"1. Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga strukturat e Gardës.

2. Punonjësi lirohet kur:

a) kur mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga organi kompetent mjekësor;

c) i miratohet kërkesa për lirim;

ç) lë shtetësinë shqiptare;

d) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykate;

dh) bëhen shkurtime në funksionet organike dhe në numrin e përgjithshëm të punonjësve;

e) kur ka vlerësime të performacës në punë dhe të rezultateve të testimeve të nivelit nën mesatar për 2 (dy) herë rresht.

3. Punonjësi përjashtohet kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) shkel betimin;

c) çënon rëndë integritetin e institucionit;

ç) nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune;

d) ka konsumuar të gjitha masat disiplinore të parashikuara.

4. Një punonjësi të liruar sipas shkronjave "c" e "dh" të pikës 2 të këtij neni i lind e drejta të konkurrojë për t'u rikthyer në strukturat e Gardës kur krijohen vende të lira.

5. Rregullat e procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthimit përcaktohen në rregulloren e Gardës."

Neni 9

Në nenin 37 bëhen ndryshimet si vijon:

1. në paragrafin 1, gërmat c), ç) dhe dh) ndryshojnë si vijon:

- | | |
|--|-----------------|
| <i>"c) nga "nënkomisar" në "komisar"</i> | <i>5 vjet;</i> |
| <i>ç) nga "komisar" në "kryekomisar"</i> | <i>5 vjet;</i> |
| <i>dh) nga "drejtues" në "drejtues i parë"</i> | <i>5 vjet."</i> |

2. Pas paragrafit 1, shtohen paragrafët 1.1 dhe 1.2 me këtë përmbajtje:

"1.1. Punonjësit të Gardës në nivelin bazë, që ka vjetërsi shërbimi mbi 5 (pesë) vjet dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës "nënkomisar".

1.2 Konkurrimi për gradën "nënkomisar" hapet kur lind nevoja për plotësimin e vendeve vakante, duke zbatuar të njëjtat rregulla dhe procedura konkurrimi si për fitimin e gradave të tjera."

Neni 10

Në nenin 38, pas paragrafit 1, gërma b) shtohet gërma b/1 me këtë përmbajtje:

"b/1) për gradën nënkomisar të ketë përfunduar kursin e trajnimit për nënkomisar;"

Neni 11

Neni 39 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

"1. Gradat nga "inspektor i dytë" deri "drejtues i parë" fitohen nëpërmjet konkurrimit për gradë.

2. Gradat "drejtues i lartë" dhe "drejtues madhor" jepen për shkak të funksionit.

3. Grada "inspektor" jepet pas përfundimit me sukses të kursit përkatës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritsë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë.

4. Grada "nënkomisar":

a) jepet pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritsë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, ose në institucione të tjera të arsimit të lartë të njësuara me të, brenda e jashtë vendit."

b) fitohet përmes konkurrimit për gradë nga punonjësit e nivelit bazë, sipas pikës 1.1 të nenit 37.

5. Komisionet e gradimeve ngrihen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

6. Rregullat dhe procedurat e zhvillimit të procesit të konkurrimit për gradë përcaktohen në rregulloren e Gardës së Republikës."

Neni 12

Në nenin 40, paragrafi 1, fjala "komisar" zëvendësohet me "nënkomisar".

Neni 13

Në nenin 41 bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

1. Paragrafi 1 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“1. Për fitimin e gradës “nënkomisar” deri “kryekomisar” kandidati vlerësohet në testimin fizik e profesional dhe intervistën me gojë.”

2. Paragrafi 2 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“2. Për fitimin e gradës “drejtues” dhe “drejtues i parë” kandidati vlerësohet në testimin profesional, me ushtrime vlerësuese dhe intervista me gojë.”

3. Pas paragrafit 2 shtohet paragrafet 2.1 dhe 2.2 me përmbajtjen si vijon:

“2.1. Për fitimin e gradës “inspektor i dytë” kandidati vlerësohet në testimin fizik e profesional.

2.2 Për fitimin e gradës “inspektor i parë” kandidati vlerësohet në testimin profesional.”

Neni 14

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 21, paragrafi 6.

Neni 15

Vendimi nr. 879, datë 27.12.2022 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat, rregullat dhe mënyrën e ekuivalentimit të gradave ushtarake me gradat e Gardës së Republikës së Shqipërisë” shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 33, DATË 31.03.2021 “PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33, datë 31.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar” (në vijim “projektligji”), ka për qëllim përmirësimin e normave ligjore të cilat, nga praktika e deritanishme kanë gjetur vështirësi në zbatim, kanë patur mungesë harmonizimi apo kanë rënë ndesh me normat e tjera të ligjit sikurse me frymën e përgjithshme që ligjvënësi ka patur parasysh në hartimin e tij. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e këtyre ndryshimeve të propozuara janë lënë si rekomandim me afat zbatimi të menjëhershëm prej grupit auditues të Ministrisë së Punëve të Brendshme në muajin dhjetor 2025.

Për sa më sipër, qëllimi i këtij projektligji është të përmirësojë, qartësojë dhe të mos krijojë ekuivoke në zbatimin e normave, të cilat janë të paqarta, duke sjellë kështu formimin e precedentëve që çojnë në keqinterpretim apo zbatim të gabuar të ligjit.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, ky projektligj synon rregullimin e disa procedurave dhe standardeve që lidhen me:

- Implementimin e rekomandimeve të grupit auditues të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me procesin e konkurrimit për gradën “nënkomisar” dhe fitimin e kësaj grade nga punonjësit e nivelit bazë. Procedura e konkurrimit nuk është parashikuar në asnjë dispozitë ligjore të ligjit apo të VKM nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të arrihet plotësimi i këtij vakumi ligjor.
- Rikonceptimin e dispozitës që lidhet me kriteret që duhet të plotësojë kandidati për funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës. Në dispozitën aktuale, të ndryshuar në vitin 2024, janë vendosur kritere të posaçme duke

cënuar parimin e sigurisë juridike për punonjësit aktualë, të cilët preken e penalizohen nga ndryshimet ligjore të fundit. Nëpërmjet këtij projektligji synohet të rregullohet ky parashikim, të respektohet e drejta e barabartë e të gjithë punonjësve të Gardës për funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm sikurse të respektohet hierarkia e gradës, e cila në vetvete përcakton funksionin.

- Krijimin e mundësisë për të pranuar në procese konkurrimi në Gardën e Republikës edhe punonjës nga strukturat e tjera të sigurisë si: Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Policia e Burgjeve, SHISH, e të tjerë.
- Qartësimin e dispozitës mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në Gardë dhe rastet kur lejohet rikthimi. Po ashtu, synohet korrigjimi i një lapsusi ligjor që gjendet në ligjin aktual në fuqi.
- Shtimin e afatit të qëndrimit në gradë për të konkurruar për përfitimin e gradës pasardhëse. Ky është një rregullim ligjor i domosdoshëm, i cili i jep mundësinë punonjësve që konkurrojnë për gradën pasardhëse të jenë më të kualifikuar profesionalisht, kur të aspirojnë të ngrihen në funksione më të larta menaxheriale.
- Qartësimin e koncepteve të dhënies së gradës dhe përfitimit të gradës në Gardë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, pasi domosdoshmëria e ndryshimit të aktit parësor, ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka dalë pas miratimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve dhe Raporti përfundimtar auditues i Ministrisë së Punëve të Brendshme është dërguar në Gardën e Republikës në muajin Janar 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji sjell përmirësime pozitive në harmonizimin e normave ligjore me njëra tjetrën, krijon qartësi në interpretimin dhe kuptimin e tyre, shmang keqinterpretimet,

e po ashtu shton rregullime procedurale të cilat nuk janë përmendur deri më tani në ligjin aktual dhe mungojnë po ashtu në aktet nënligjore në zbatim të tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi, garanton zbatimin e tyre, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 i projektligjit ndryshon paragrafin 1 të nenit 6 duke shtuar pas fjalës “drejtorie” edhe fjalën “njësie”. Ky ndryshim është i domosdoshëm pasi në strukturën organizative të Gardës, parashikuar në nenin 6 të VKM nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë” dhe po ashtu në strukturën e miratuar me Urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme, sikurse në praktikë “njësia” është e përfshirë në organizimin e institucionit.

Neni 2 i projektligjit sjell ndryshime dhe shfuqizime në nenin 17 të ligjit që flet për kriteret e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm. Konkretisht:

1. Paragrafi i parë ndryshohet me këtë përmbajtje “*Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit dhe i jepet grada “Drejtues Madhor”. Ai përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Gardës që mbajnë gradën “Drejtues i Parë/Drejtues i Lartë”.*”

Ky ndryshim vjen për shkak se:

Në dispozitën aktuale në fuqi, është parashikuar vetëm që kandidati për drejtor të përgjithshëm të ketë minimalisht 10 vite eksperiencë në fushën e rendit ose të sigurisë. Referuar sistemit të gradave punonjësi e fiton gradën “drejtues” për

minimalisht 11 vite (me ndryshimet e propozuara 15 vite) qëndrimi në strukturat me gradë. Niveli i aftësive profesionale e menaxheriale për kandidatin për këtë funksion, sipër rendit *funksion-gradë* i përket punonjësit të nivelit të mesëm (deri në kryekomisar). Nëse një punonjës me gradën Kryekomisar përzgjidhet për të ushtruar funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm, duke fituar për shkak të funksionit edhe gradën “drejtues madhor”, çon automatikisht në prishjen e sistemin e hierarkisë dhe karrierës në strukturat e Gardës së Republikës. Shtojmë këtu faktin se këtë kriter mund ta plotësojnë edhe punonjësit e nivelit bazë në Gardën e Republikës, me gradat “inspektor” deri në “inspektor i dytë”, të cilët zotërojnë diplomë të nivelit master.

Po ashtu, sipas parashikimit të nenit 19 të ligjit 33/2021, zëvendës drejtori zgjidhet nga radhët e punonjësve të Gardës që mbajnë gradën “drejtues i parë”, e cila fitohet duke qëndruar në karrierë *prej minimumi 14 vite* (me ndryshimet e propozuara 20 vite). Nga ana tjetër, Drejtori i Përgjithshëm përzgjidhet ndër punonjësit që ka qëndruar në karrierë me minimumi 10 vite pa përcaktuar se në radhët e cilit nivel punonjësish përzgjidhet (punonjës të nivelit bazë, të mesëm, të lartë apo madhor).

Bazuar në specifikën e veçantë të punës së institucionit, në misionin e tij që nuk përngjason me institucione të tjera të sigurisë, por edhe për të çuar përpara karrierën e punonjësve të Gardës, si kriter është vendosur që drejtori të përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Gardës së Republikës. ky kriter është në harmoni edhe me nenin 19 të ligjit që parashikon se edhe zëvendës drejtori i përgjithshëm përzgjidhet po ashtu nga radhët e punonjësve të Gardës.

Si përfundim, parashikimi aktual i gërmës d) të paragrafit 2, të nenit 17 bie në kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e nenit 19 dhe nenit 33 (në të cilin parashikohet se “*sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit në Gardën e Republikës*”), duke krijuar një konflikt logjik në zbatimin e tyre

Sa më sipër, është parashikuar vendosja e kriterit të gradës “drejtues i parë/drejtes i lartë” për kandidatin e funksionit të drejtorit të përgjithshëm.

2. Shfuqizohet gërma d) e paragrafit të dytë, pasi bie ndesh me kriterin e gradës Drejtues i parë/ drejtues i lartë, të shtuar për funksionin e drejtorit të përgjithshëm.

3. Shfuqizohet gërma dh) e paragrafit të dytë që lidhet me kriterin e diplomës së nivelit të dytë, pasi:

Referuar nenit 68 të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se gradat e fituara sipas ligjit 9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë” ekuivalentohen me gradat e parashikuara në ligji 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. Kjo nënkupton që ato njësohen, janë të barabarta dhe trajtohen sikur të ishin fituar sipas ligjit aktual në fuqi. Në këtë kuptim, punonjësit e Gardës së Republikës, me gradat e fituara me ligjin e shfuqizuar, janë kandidatë të barabartë për funksionin Drejtor i Përgjithshëm, me punonjësit të cilët kanë fituar gradat sipas kritereve të parashikuara në ligjin 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. Po ashtu, sipas parimit të sigurisë juridike, nënkupton se ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Sipas këtij parimi, një oficer karriere, që ka përfituar të gjitha gradat në mënyrë ligjore nuk mund të penalizohet për shkak të ndryshimeve ligjore dhe t’i mohohen të drejtat e fituara sipas një ligji të shfuqizuar, duke penalizuar kështu përparimin e tij në gradë e karrierë.

4. Ndryshim i gërmës e) të paragrafit të dytë duke shtuar kriterin që kandidati për drejtor të përgjithshëm të mos ketë masa për shkelje disiplinore për shkelje të rënda brenda 3 viteve të fundit dhe jo vetëm në fuqi në momentin e propozimit.

Neni 3 i projektligjit ndryshon nenin 19 me emërtimin “zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive”. Ky nen është riformuluar me qëllim qartësimin për kriteret e funksionit të zëvendës drejtorit të përgjithshëm dhe janë shfuqizuar paragrafët 5 dhe 6.

Paragrafi 5 kufizon kohën e ushtrimit të kompetencave të drejtorit të përgjithshëm prej zëvendës drejtorit të përgjithshëm, me një afat deri në 6 muaj, i cili bie ndesh me afatet e parashikuara nga legjislacioni penal në rastet e fillimit të ndjekjes penale për funksionarin publik (në rastin konkret drejtorit të përgjithshëm).

Paragrafi 6 është shfuqizuar pasi funksioni “drejtor drejtorie” nuk është i barasvlefshëm për nga hierarkia me zëvendës drejtorin e përgjithshëm e për rrjedhojë nuk duhet të jetë as nga grada. Po ashtu, ky paragraf bie ndesh edhe me nenin 33 të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se *“sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit në Gardën e Republikës”*.

Neni 4 i projektligjit sjell ndryshime dhe shtesa në nenin 21, si vijon:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33, datë 31.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”.

Paragrafi 3 ndryshon përmbajtje duke shkruar edhe nenin 23 në këtë paragraf. Ky ndryshim është bërë për t'i krijuar mundësi edhe punonjësve të strukturave të tjera të sigurisë, të cilët kanë gradën “inspektor” deri “komisar” dhe janë të moshës deri në 40 vjeç, mund të konkurrojnë për t'u punësuar në Gardën e Republikës. Kalimi në Gardë parashikohet të realizohet duke ruajtur dhe njohur vjetërsinë e shërbimit. Pas paragrafit 5 shtohet paragrafi 6 nëpërmjet të cilit parashikohet se rregullimet e detajuara bëhen me vendim të këshillit të ministrave.

Neni 5 i projektligjit shfuqizon nenin 23, i cili shkrihet në pikën 3 të nenit 21.

Neni 6 i projektligjit ndryshon paragrafin 2 të nenit 28, duke rregulluar një vakum ligjor që ka sjellë problematika në zbatim në kuadër të organizimit të shërbimeve të sigurisë.

Neni 7 i projektligjit sjell rregullime mbi vakumin ligjor që lidhet me rastet e pezullimit të punonjësve nga detyra, duke harmonizuar parashikimet ligjore që parashikon VKM nr. 777, datë 15.12.2021 me këtë nen të ligjit.

Neni 8 i projektligjit riformulon nenin 30, duke bërë një ndarje më të qartë mes rasteve kur punonjësi lirohet nga strukturat e Gardës dhe kur përjashtohet.

Neni 9 i projektligjit ndryshon dhe bën shtesa në nenin 37, lidhur me afatet e qëndrimit në gradë për punonjësit që konkurrojnë për gradën e radhës. Rritja e afatit të qëndrimit në gradë për gradat nga: “nënkomisar” në “komisar”; nga “komisar” në “kryekomisar”; nga “drejtues” në “drejtues i parë” unifikohet në 5 (pesë) vite dhe krijon përparësi për strukturat e Gardës pasi sjell një rritje të profesionalizmit dhe eksperiencës së punonjësve të niveleve menaxheriale. Po ashtu, pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë, 1.1 dhe 1.2 për të rregulluar procedurën e konkurrimit për gradën “nënkomisar”, i cili ishte një vakum ligjor, i lënë si rekomandim për t'u ndryshuar në ligj prej grupit të auditit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në dhjetor 2025, me afat zbatimi të menjëhershëm.

Neni 10 i projektligjit shton gërmën b/l në paragrafin 1, të nenit 38. Ky shtim është bërë sërish për të rregulluar procedurën e fitimit të gradës “nënkomisar”.

Neni 11 i projektligjit riformulon nenin 39, me qëllim qartësimin e kësaj dispozite.

Neni 12 i projektligjit zëvendëson fjalën “komisar” me “nënkomisar” për të rregulluar procedurën e fitimit të gradës “nënkomisar”.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33, datë 31.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”.

Neni 13 i projektligjit bën shtesa dhe ndryshime në nenin 41, në të cilin parashikohen fazat e testimit të kandidatëve për konkurrimin për gradë. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të përmirësohen fazat e konkurimit duke u përforcuar më tej procedurat e konkurimit për gradë. Shtohet testimi fizik për gradat e ulëta, duke harmonizuar kështu njëkohësisht edhe parashikimet ligjore të VKM nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, me ato të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 14 i projektligjit ngarkon Këshillin e Ministrave për të nxjerrë aktin nënligjorë në zbatim të nenit 21, paragrafi 6, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e projektligjit.

Neni 15 i projektligjit shfuqizon VKM nr. 879, datë 27.12.2022 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat, rregullat dhe mënyrën e ekuivalentimit të gradave ushtarake me gradat e Gardës së Republikës së Shqipërisë”.

Neni 16 i projektligjit parashikon afatin 15 ditor të hyrjes në fuqi të këtij projektligji pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje me rregullat e përgjithshme për hyrjen në fuqi të ligjeve.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës.


VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Këshilli i Ministrave, Ministria e Punëve të Brendshme, Garda e Republikës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare.

PROPOZUESI



Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33, datë 31.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”.